

SCULPFEST IV EDITION

NGJARJA NDËRKOMBËTARE E ARTIT BASHKËKOHOR
INTERNATIONAL CONTEMPORARY ART EVENT



1-3 Maj / May 2015 Prizren / Kosovë

ORGANIZOHET NGA / ORGANIZED BY:

AUTOSTRADA BIENNALE


PARTNER KURATORAL / CURATORIAL PARTNER:


M.A.M. FOUNDATION



INDEX / PËRMBAJTJA

4. Evolucionimi i SculpFest
5. SculpFest Evolution
6. Koncept Autostrada Biennale
7. Concept Autostrada Biennale
8. Program / Programi / 01 Maj 2015
9. Performanca me 20.000 Kube të Akullit
10. Performance with 20.000 Ice Cube
11. Hartë për / Map for / 01 Maj
12. Posteri / Poster
13. Program / Programi / 02 Maj 2015
14. Përmbajtje Eventi / 2 Maj
15. Content Event / 2 Maj
16. . Hartë për / Map for / 02 Maj
17. Euro Center Parking
18. Tekst Kuratorial
20. Curatorial Text
22. Conny Karlsson Lundgren
24. OPA





26. Ozan Ünal

28. Agron Blakçori

30. Boban Anastasi

34. DyZeroTre

36. Ranko Djanković & Sanja Latinović

38. Shpend Havolli

40. Program / Programi / 03 Maj 2015


41. Hartë për / Map for / 03 Maj

42. Organizata / Organization

43. Stafi / Team

44. Falenderimet / Thanks

45. Sponzorët / Sponsors



Evolucioni i SculpFest

Festivali ndërkombëtar i skulpturës SculpFest është i vetmi i tillë, jo vetëm në Kosovë por edhe në tërë Ballkanin. SculpFest si festival i skulpturës (por pa skulpturë në të), përgjatë organizimeve 2012 - 2014, kishte për qëllim të trajtonte tema aktuale me aktivitete të ndryshme artistike vetëdijesuese, ku skulptura shihej dhe trajtohej në dimension më të gjerë përmbajtësor. Në kuadër të Sculp Fest ishin dy projekte “Sculp’ice” dhe “Sculp’edu”, të cilat deri në vitin 2014 u organizuan nga OJQ Leo’s Art Organisation. Këto dy festivale kishin për qëllim që të rrisin nivelin e vetëdijes për artin bashkëkohor dhe të përgatisin bazën dhe përvojën organizative për evenimentin më të madh, atë të Autostrada Biennale që do të mbahet për herë të parë në verën e vitit 2017. SculpFest vazhdon me edicionin e saj të katërt me festivalin e akullit “Sculp’ice” i cili do të mbahet nga 1-3 Maj 2015 në Prizren, duke e përmyllur një cikël të suksesshëm të ngjarjeve artistike, përfshirë prezantime të ndryshme të artistëve, krijime, punëtori, performanca dhe muzikë, të cilat kanë inspiruar dhe hapur rrugë për organizimin e bienales së artit bashkëkohor Autostrada Biennale 2016/2017.

SculpFest Evolution

International sculpture festival “SculpFest” is a unique sculpture festival not only in Kosovo but also in the Balkan region. SculpFest as a sculpture festival (different sculpture concept), throughout the organizations held from 2012 to 2014, aimed in addressing actual social issues through different awareness activities where sculpture was seen and was treated in broader dimension. Sculp Fest is a festival that included two projects, “Sculp’ice” and “Sculp’edu” which from 2012-2014 were organized by Leo’s Art Organization. These two festivals aimed in increasing the level of awareness for contemporary art, while preparing the base for the biggest event, planned to be held in 2017 named Autostrada Biennale. Sculp’Ice 2015 is the continuation of Sculp Fest’s fourth edition, planned to be organized from 1st to 3rd of May 2015 in Prizren, thus giving the closure of a successful cycle of artistic events including but not limited to: presentation of different creations of different artists, workshops, musical performances, etc. All these events have inspired and paved the way for the organization of the Biennale of the Contemporary Art “Autostrada Biennale” 2016/2017.

AUTOSTRADA BIENNALE

Autostrada Bienale është themeluar me misionin për të përmirësuar kulturën dhe për të ringjallur komunitetin e saj. Autostrada Bienale është një autostradë inovative midis Bienales së Stambollit, Bienales së Venecias dhe Prizrenit. Hapësirat do të jenë rrugicat dhe lumi “Lumbardhi” në Prizren, Kosovë. Frymëzuar nga bota e sotme që ndryshon, kjo është iniciuar në mënyrë që të përfitojë dhe të zgjerohet nga rritja e shkëmbimit artistik dhe shkëmbimit të praktikave. Përmes një fryme të bashkëpunimit ne do të kërkojmë të zgjojmë energjinë krijuese të Kosovës, rajonit dhe më gjerë. Bashkëpunimi në mes të fushave të ndryshme të artit dhe vënia në pikëpyetje e problemeve dhe vështirësive të botës kontemporane është një aspekt novator i artit sot. Kjo sfidon dhe shkëmben bashkëpunimin. Harald Szeemann në përmbledhjen e vet për përmbajtjen e shfaqjes, sinjalizoi këtë ndryshim në marrëdhëniet e artistit, studios dhe muzet: “E kundërta e dukshme me formën; shkalla e lartë e angazhimit personal dhe emocional; prononcimi që objekte të caktuara janë art, edhe pse ato nuk kanë qenë më parë të përcaktuara si të tilla; zhvendosja e interesit larg nga rezultati drejtë procesit artistik; përdorimi i objekteve të zakonshme; ndërveprimi i punës dhe materialit; Nëna Tokë si medium, vend pune, shkretëtira si koncept.” Autostrada Bienale është një fabrikë utopike, dhe vendpunishte në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Kjo synon të nxjerrë në pah kushtet sociale, politike, ekonomike dhe estetike, të cilat gjithashtu ndikojnë në jetën e përditshme përtej botës së artit: “Të bëjmë qytetin muze në vetvete është lëvizje kontemporane”. Një vend ku përvojat lokale të kohës shkatërrojnë unitetin e pranimit dhe shpikjes së kohës së vet.



AUTOSTRADA BIENNALE

Autostrada Biennale Prizren has been established with the mission to enhance culture and revitalizing its community.

Autostrada Biennale is an innovative highway between Istanbul Biennale, Venice Biennial and Prizeren. The spaces will be in the alleyway's and "Lumbardhi" river in Prizren, Kosova. Inspired by today's changing world and it is initiated in order to take advantage and expand upon the increased artistic exchange and practice. Through a spirit of cooperation we will seek to awaken Kosova's, region, creative energy and beyond.

Collaboration between different art fields and to question the problems and difficulties of the contemporary world is a groundbreaking of aspect of art today. It challenges and exchanges collaboration.

Harald Szeemann's own summary of the show's content was itself lengthy, but it signaled this shift in the relationship of artist, studio and museum: "the obvious opposition to form; the high degree of personal and emotional engagement; the pronouncement that certain objects are art, although they have not previously been defined as such; the shift of interest away from the result towards the artistic process; the use of mundane objects; the interaction of work and material; Mother Earth as medium, workplace, the desert as concept."

Autostrada Biennale is an utopian factory and work place in the best sense of the meaning. It plans to highlight social, political, economical and aesthetic conditions, which also influence everyday life beyond the art world: to make the city as a museum itself is a site of contemporaneity. A place in where local experiences of time subvert the unity of embracing and inventing its own time.

1 May 2015

Marin Barleti street Casbah / Prizren

20:30 Hapja Solemne e Edicionit të IV të SculpFest;
Opening Ceremony of 4th edition of SculpFest

20:50 Performancë e Artit Bashkëkohor me 20.000 kube të akullit
Contemporary Art Performance with 20.000 ice cubes

21:00 Jazz Music:

Ilir Bajri – Keys,
Fation Miftari – Keys,
Tomor Kuci – Guitar & Kays,
Visar Kuci – Bass & Guitar & Keys,
Enes Bajramliq – Drums,
Labinot Sponca – DJ.



Performanca me 20.000 Kube të Akullit

Edicionin e ri të Sculp'ice do ta karakterizoj performanca me 20,000 kube të akullit të cilat do të përdoren si metaforë e “Kalldrëmit të Vjetër”.

Projekti nismëtar ka në qendër identitetin historik të rrugëve të Prizrenit dhe trashëgiminë shpirtërore të vendit.

I emërtuar sipas zhargonit lokal të Prizrenit, projekti “Kalldrëm” do të përmbledhë përjetimet e banorëve dhe vizitorëve në rrugët e gurta të qytetit.

Fletë të shumta janë vendosur në lisa nëpër rrugët e Prizrenit që kanë filluar të veshën me rrëfime të përjetimeve mbi kalldrëm. Për ata që s'mund të jenë fizikisht, është zhvilluar platforma virtuale www.kallderm.net.

Në 20.000 kube të akullit do të “ngrihen” rrëfimet e qytetarëve, të cilat do të mbulojnë rrugë në Prizren, duke dëshmuar se përtej çdo objekti e ngjarjeje në jetën e qytetit, ka histori e ndjesi njerëzore.

Qëllimi i kësaj performance bashkëkohore është të shtjellohet tema e trashëgimisë kulturore dhe vlerat historike që posedojnë ato. Ndërkohë shkrimet ku përfshihen komentet dhe dëshirat e qytetarëve do të mbesin si një akt i shprehjes së lirë dhe një mënyrë e komunikimit të njerëzve me hapësirën, pra në këtë rast me qendrën historike të Prizrenit.

Performance with 20.000 Ice Cubes


New edition of Sculp'ice will be characterized by the performance including 20.000 small ice cubes, which will be used as metaphore for “old cobblestones”.

The project itself is focused on historical identity of the streets of Prizren and spiritual heritage of the city.

The project “Kalldërm”, slang word for cobblestones from Prizren inhabitants, will collect experiences of the citizens and visitors in the stony streets of the city.

Trees of the streets of Prizren are being covered with letters that contain stories from experiences of walking through the way paved with cobblestones. For those who cannot be there physically, the virtual platform www.kallderm.net has been released. Stories of the citizens will be ‘frozen’ in a record number of 20.000 ice cubes. These cubes will cover one of the main streets of city centre of Prizren, showing that through every object and event, happening in the life of the city there is an amazing human history.

The main objective of this contemporary performance is to treat the issue of cultural heritage and the historical value that they possess. On the other hand, experiences and comments placed by citizens’ aim in promotion of freedom of speech and the act of communication with the space, which in this project includes the historical part of Prizren.



KUJDES RRËSHQET



organizohet nga / organized by: Autostrada Biennale



sculp'ice / edicioni IV edition / 1-3 Maj / May 2015

performance e artit bashkëkohor me 20.000 kube të akullit.

contemporary performance with 20.000 ice cubes

data / date: 01 Maj / May 2015

koha / time: 20:30h

vendi / place: Rruga Marin Barleti / Prizren / Kosovo

www.sculpfest.com

www.autostradabiennale.org

www.kallderm.net

2 May 2015

Ngjarja Ndërkombëtare e Artit Bashkëkohor Internatioal Contemporary Art Event

Street "Adnan Krasniqi" nr. 149 / Eurocenter building (-3rd floor) / Prizren

- 21:00 Hapja Solemne - "Prezentimi i Autostrada Biennale"
Opening Ceremony – "Autostrada Biennale Presentation"
Leutrim Fishekqiu
- 21:30 Fjalim i Artistit - "Rëndësija e Diplomacisë Kulturore"
Artist Talk – "The Importance of Cultural Diplomacy"
Panelist: Veton Nurkollari, Moderator: Ares Shporta
- 22:00 "Project Which Is Not a Project", Video, 42', 2006, O.P.A. (MKD)
- "NEW LIFE" - Sculpture Performance, Ozan Unal (TUR)
- "KONCERT NË VITIN 2014"
Video art, Conny Karlsson Lundgren (SWE)
- "REFLECTION OF THE CHARACTER"
Video installation, Agron Blakçori (RKS)
- "POST FATA RESURGO" - Performance
Video Documentation 8'12" – 2014, DyZeroTre (ITL)
- "HISTØRI removing" - Action - video 3'52" – 2012, DyZeroTre (ITL)
- "MOVEMENTS: WHITE" (2012) – Performance Installation, Sanja Latinović
and Ranko Djankovic (SRB)
- "REFLEXION" Video Installation, Shpend Havolli (RKS)
- "Between" Performance Boban Anastasi (AL)
- "Jehone (y serious)" (RKS)

PARKING” PËR NJË NISJE TË RE TË PROJEKTEVE TË NDRYSHME BASHKËKOHORE NË KUADËR TË AUTOSTRADA BIENNALE

Festivali Ndërkombëtar i Skulpturës SculpFest në edicionin e tij të katërt, i cili do të organizohet si pararendës i Autostrada Biennale (Biennale Ndërkombëtare e Artit Bashkëkohor), do të organizoj ngjarjen bashkëkohore me moton “Na u shkri akulli, çka me bo tash?!”

Njëra nga hapësirat e përzgjedhura për këtë edicion është “Parking” i cili ndodhet në rrugën “Adnan Krasniqi” nr. 149 në ndërtesën e EuroCenter(kati -3).

Kjo hapësirë e “Parkingut” në mënyrë metaforike paraqet një gjendje aktuale të ndalimit, me qëllim të një nisjeje të re të projekteve të ndryshme bashkëkohore në kuadër të Autostrada Biennale (Biennialja Ndërkombëtare e Artit Bashkëkohor). Partner kuratorial i eventit është M.A.M. Foundation me kuratorin Klod Dedja.

Eventi do të mbahet në Prizren/Kosovë me datën 2 Maj 2015 duke filluar nga ora 21:00- 02:00. Përgjatë 5 orëve sa do të zgjasë programi do të ketë prezantime të ndryshme të artistëve, skulptura, instalacione, video art, punëtori, performanca dhe muzikë.

Në këtë ngjarje do të ketë artistë të mirënjohur nga skena e artit bashkëkohor të cilët vijnë nga vende të ndryshme të Evropës. Artistet pjesëmarrës:

- Conny Karlsson Lundgren – SUEDI
- Ozan Unal – TURQI
- Boban Anastasi – SHQIPERI
- Agron Blakqori – KOSOVE
- O.P.A. – MAQEDONI
- Shpend Havolli – KOSOVE
- Sanja Latinovic – SERBI
- Ranko Djankovic – SERBI
- DyZeroTre – ITALI

PARKING” A NEW BEGINNING OF VARIOUS CONTEMPORARY PROJECTS WITHIN AUTOSTRADA BIENNALE

The fourth edition of International Sculpture Festival SculpFest will organise the contemporary event with the motto “Ice is melted, what now?!”.


This edition which will be organised by Autostrada Biennale will be an initiative for the use of alternative spaces for organization of different events in the framework of contemporary art. One of the chosen spaces for this edition is “car parking” which takes place in “Adnan Krasniqi” Street nr. 149 Eurocenter building (-3rd floor).

This venue will present the current state of the bringing to an end of one activity, with the aim of the beginning of the newer cultural activities in the bigger project yet to come Autostrada Biennale (International Contemporary Art Biennale).

The event will be held in Prizren/Kosovo, on May 2, 2015 starting from 21:00 – 02:00. During this period of 5 hours presentations of various artists, sculptures, installations, video documentaries, workshops, performances and music will be present. Curatorial Partner for this event is M.A.M Foundation with curator Klod Dedja.

Well-known artists from the scene of contemporary art from around Europe will be part of this event. Participating artists are:

- Conny Karlsson Lundgren – SWEDEN
- Ozan Unal – TURKEY
- Boban Anastasi – ALBANIA
- Agron Blakqori – KOSOVO
- O.P.A. – MACEDONIA
- Shpend Havolli – KOSOVO
- Sanja Latinovic – SERBIA
- Ranko Djankovic – SERBIA
- DyZeroTre – ITALY





Euro Center building (-3rd floor) / Parking





tekst kuratorial për
SculpFest IV –
Autostrada Biennale
/ Prizren / Kosove
maj 01-03, 2015



ARTI BËHET GJITHMONË

NGA ZERO

kurator Klod Dedja

Autostrada Biennale prezanton Eventin Ndërkombëtar të Arteve Bashkëkohore në një nga vendet më të bukura në Ballkan, me histori qindra vjeçare të qytetit të Prizrenit, i cili ndodhet në jug të Republikës së Kosovës. I pozicionuar në qendër të Ballkanit, ky qytet me një ndërthurje arkitekturore të mrekullueshme (otomane, austro-hungareze), kërkon të shkojë përtej vlerave historike duke lançuar forma të reja të artit ndërkombëtar.

Konteksti i artit bashkëkohor bëhet akoma me konkures me idetë e veta, sidomos kur vendi ku zhvillohet është specifikisht një vend aspak bashkëkohor por historik. Përzgjedhja e Prizrenit (në jug të Kosovës) si vend për të zhvilluar një event të tillë, shfaq rrezikun apo paradoksin e moskuptimit apo të “ajrit jo kontemporan” për t’u kuptuar, si në vendet e tjera epiqendër të artit si: Berlin, Paris, Londer, NewYork, etj.

Midis këtyre paradokseve ekzotiko-historike, arti merr një peshë tjetër me një shije të freskët dhe kompromente, sikur të donim të ënderrnim mbi vlera të reja dhe hapsira të reja eksperimentimi. Idealizmi i kësaj përpjekje për t’u shfaqur ndryshe edhe në periferinë e skenes së artit, ndërton një parametër eksitues mbi perceptimin e një lloj produkti të ri bashkëkohor...një lloj produkt-shpresë.

Mbivendosja e idealizmit në periferi të skenës botërore të artit, bën të vërtetesh rreth e rrotull vetëvetes sikur të rindërtosh një tjetër botë jo ekzistuese, e cila (kjo botë tjetër) nuk reagon spontanisht por konkretisht, duke marrë përsiper zgjerimin e sistemeve të artit bashkëkohor në Ballkan e përtej... Këto propozime, të cilat lindin aty ku nuk imagjinohet, do të jenë pikërisht “shpresat” dhe “burimet e padukshme” të së ardhmes.

Prizreni edhe pse periferik dhe jo ekzistues në hartën e artit botëror, kërkon të vetëlançohet me energji konkrete dhe koncepte, të cilat tentojnë të “modifikojnë” sado pak këtë hartë, duke u nisur pikërisht nga vetvetja... nga zero-ja. Mbi këtë parametër paradoksal dhe idealist për të hapur “dyer emergjente” futuriste dhe funksionues, mbështet koncepti kuratorial i eventit SculpFest IV- Autostrada Biennale.

Artistët e ftuar janë : Ozan UNAL (Tukey), Shpend Havolli (Kosovë), DYZEROTRE Collective (Italy), Sanja LATINOVIC & Ranko DJANCOVIC (Serbia), Conny Karlsson LUNDGREN (Sweden), Jehone (y- serious) Kosove, Boban ANASTASI (Albania), Agron BLAKÇORI (Kosove).

Përzgjedhja e artistëve është bërë mbi kontekste simbolikash të holla dhe direkte. Artistët sjellin në Autostrada Biennale copëza hulumtuesh personale si këndvështrime mbi probleme të padukshme sociale apo gjendje emocionale mbi kontradita njerzore. Mbi këto fije të holla kufijsh-simbolik, veprat e artistëve relaksionojnë në mënyrë perfekte me parkimin-galeri nëntokësor, i cili në vetëvete ky parkim është një art-installation ironik.

Veprat e tyre bazohen mbi perceptime totalisht sociale, dhe ky element i përbashket përbën specifikën e këtij event, i cili u përzgjedh të organizohet tre kate nën toke, nën një parkim publik me emrin “Euro Center” , diku në qendër të qytetit historik. Në peshën e strukturës prej betoni të “Euro Center”, nën tre kate , nis eventi i artit bashkëkohor Autostrada Biennale me: performancë, video art, installation.

Duke u kthyer në konceptin e përzgjedhjes së veprave apo vendit ekspozues, kjo galeri-parkim shëndërrohet në hapsirë tejet provokuese si një tension simbolik, i cili rritet ngadalë për të propozuar forma të reja të komunikimit ndërmjet artit emergjent dhe strukturave të vjetra konvencionale artistike në zonen e Ballkanit.

Sikur të donim të fillonim nga e para çdo herë, ky event kërkon të tregojë që ARTI BËHET GJITHMONË NGA ZERO.
“...Boshi mbushet vetëm me ngjyra...” - Albert Camus.

(Rrugë të mbarë Prizreni i së ardhmes....).

Kuratori.

ART ALWAYS STARTS FROM ZERO

Curator Klod Dedja



Curatorial text for
SculpFest IV- (Autostrada Bienale)
Prizren / Kosovo
May 01-03, 2015



Autostrada Biennale presents an international event of contemporary art in one of the finest cities with meaningful years of history left behind, Prizren, which is located in the southern part of the Republic of Kosovo. Positioned in the center of Balkan, this city, correlating a wonderful variety of architectural styles (Ottoman, Austro-Hungarian), tries to move ahead of the historical values by launching innovative forms of international art.

The contemporary art contest becomes even more competitive with its own ideas, especially when its location is specifically in a city contrary to contemporary, historical. Selecting Prizren (In South of Kosovo) for a contemporary event, emphasizes the risk or the paradox of uncomprehending the “contemporary spirit”, to be perceived just like in other “epicenters” of art like: Berlin, Paris, London, New York, Beijing, etc.

In-between these exotic-historical paradoxes, art gains a compromising fresh flavored importance, as if we wish to dream about new values and new experimental spaces. Idealizing this effort to be exposed differently even in the suburb scenes of art, it builds an exciting dimension against the perception of a new type of contemporary product... some kind of “hope-product”.

The process of overlapping idealism in the peripheral world-wide scene, makes you revolve around your own like you want to rebuilt another non excising world, which does not react spontaneously but concretely, by taking over the expansion of contemporary art’s systems in Balkan and beyond... These proposals, which germinate in unimaginative places, will be the very “hopes” and “invisible sources” of the future.

Even if located in the suburbs and almost non-existent in the world-wide art map, seeks to be self-launched with concrete energies and concepts, which tend to “modify” even a little this map, by initiating from thy-self...from zero. The curatorial concept of SculpFest - The Autostrada Biennale sustains upon this paradoxical and idealistic parameter to open futuristic and efficient “emergency doors”

Invited artists: Ozan UNAL (Turkey), Shpend Havolli (Kosovo), DYZEROTRE Collective (Italy), Sanja LATINOVIC & Ranko DJANCOVIC (Serbia), Conny Karlsson LUNDGREN (Sweden), Jehone (y- serious) Kosovo, Boban ANASTASI (Albania), Agron BLAKÇORI (Kosovo).

The selection of the artists was made according to smooth and direct symbolic. Artists bring to the Autostrada Biennale small pieces of personal research as points of view regarding invisible social problems or emotional states against human contradicts. Upon these thin boundaries, artist's works relates in a perfect way with the underground gallery-garage, which is an ironic art installation.

Setting bases upon social perceptions is the common element of each artist's work and this is exactly what is unique about this event which will take place three floors underground in a big public parking lot named "Euro Center", somewhere in the center of this historical old city.

The contemporary art event Autostrada Biennale will start under the pressure of the cement structure of "Euro Center", three floors underground with: performance, video art, installations.

Coming back to the selection's concept of the artist's works and the exposure space, this garage-gallery transforms into a very provocative space as symbolic tension, which grows gradually to propose new forms of communication between emergency art and old convectional artistic structures in Ballkan.

Only if we may want to start from the beginning every time, this event will seek to show that ART WILL ALWAYS START FROM ZERO. -

"... The emptiness is filled only with colors..."

Albert Camus

(have a nice passage Prizren of the future !...)

The Curator.

Conny Karlsson Lundgren

Conny Karlsson Lundgren është artist vizual suedez i vendosur në Stockholm dhe Berlin. Ai përmes filmit, shkrimeve, imazhit dhe dokumenteve, hedh dritë mbi kufijtë midis identiteteve sociale, politike dhe private, dhe aktualisht hulumton potencialin e përdorimit të tregimeve të kundërta si mjete të rezistencës. Me situata të sjella në mënyra të ndryshme dhe gjurmë historike të rishikuara, ai ndërlikohet fenomenet që në dukje janë të pangjashme dhe sjellë një lexim alternativ e momente marramendëse në një situatë kur kjo mund të mos jetë më prezentë. Anomalitë dhe zhvendosjet që lindin dhe ushqejnë një synim për të identifikuar perspektiva dhe kuptime të reja. Punët e Karlsson Lundgren janë ekspozuar në Gothenburg Art Museum, Kunstihoone Tallinn, Zeta Gallery Tirana, Gallery September Berlin, Moderna Museet Stockholm dhe në Bienalen e pestë të Berlinit. Ai së fundmi ka realizuar një ekspozitë të madhe personale në Kalmar Art Museum në Suedi, dhe projekti i tij i fundit “Koncert në vitin 2014” është përzgjedhur si një ndër dhjetë nominimet për FOKUS 2015 që mbahet në Kunsthall Nikolaj në Kopenhagë. Ai ka titullin Master i Arteve të Bukura nga Valand Academy of Fine Arts në Gothenburg. Në vitin 2013 ka marrë pjesë në programin e rezidencave IASP (International Artists Studio Program) në Stockholm dhe gjatë vitit 2014-2015 është regjistruar programin pasuniversitar Jan van Eyck në Maasrticht, Holandë.



“KONCERT NË VITIN 2014” Video art

Ky projekt nisët nga filmi shqiptar “Koncert në vitin 1936” (Saimir Kumburo, 1978) dhe biografia e sopranos shqiptare Tefta Tashko-Koço (1910-1947). Filmi mund të kuptohet si një formulim delikat por ende si një kritikë e mprehtë e sistemit komunist (nga) brenda vet sistemit. Si katalizator në film, dy gra që udhëtojnë, një soprano dhe një pianiste, këndojnë këngën ”Zare Trëndafille”, një këngë dashurie shumë e njohur që i kushtohet një gruaje. Ajo është pjesë e traditës lirike shqiptare që u bë e njohur në vitet 1930-ta nga Tefta Tashko-Koço. Me një performancë të rivënë në skenë nga një interpretues i ri i lidhur me organizatën për të drejtat e njeriut dhe komunitetit LGBT “Aleanca LGBT”, në objektin e rrënuar të Piramidës, hetohen ngjyrimet dhe kuptimi i vet këngës. Kjo ngre pyetjet se si janë duke u përdorur tregimet ekzistuese, se si këto mund të interpretohen, dhe se si dikush iu krijon identitet dhe i bën ato të vetat. “Koncert në vitin 2014” u bë i mundur përmes një bashkëpunimi të ngushtë midis organizatës shqiptare “Aleanca LGBT” dhe ”Swedish Unstraight Museum”.

Conny Karlsson Lundgren (b. Västervik, Sweden) is a Swedish visual artist based in Stockholm and Berlin. Through film, text, image and documents he sheds light on the boundaries between social, political and private identities, and currently explores a potentiality in employing biographical counter narratives as tools for resistance. In various staged situations and revisited historical

traces, he interlinks seemingly disparate phenomena and introduces an alternative reading and queer moments in situations where this might not already be present. The glitches and dislocations that arise harbor an intention to identify new perspectives and meanings. Karlsson Lundgren's work has been exhibited in diverse contexts such as Gothenburg Art Museum, Kunstihoone Tallinn, Zeta Gallery Tirana, Gallery September Berlin, Moderna Museet Stockholm and the 5th Berlin Biennale. He recently had a major solo museum exhibition at Kalmar Art Museum in Sweden and his recent project *Koncert në Vitin 2014* was selected as one of ten nominees for the FOKUS 2015 held at Kunsthall Nikolaj in Copenhagen. He holds an MFA in Fine Arts from Valand Academy of Fine Arts in Gothenburg. In 2013 he participated in the IASPIS Studio Residency Program in Stockholm and during 2014-2015 he was enrolled at the Jan van Eyck Post Academic Studio Research Program in Maastricht, The Netherlands.

“KONCERT NË VITIN 2014” - Video art

www.connykarlsson.se



The project departs from the Albanian film *Koncert në Vitin 1936* (Saimir Kumburo, 1978) and the biography of the Albanian soprano Tefta Tashko-Koço (1910–1947). The film can be understood as formulating a subtle; yet sharp critique of the Communist system (from) within the system itself. As catalyst in the film, two traveling women – a soprano and a pianist – perform *Zare Trëntafile* a well-known love song addressed to a woman. It is part of the Albanian Urban Lyrics tradition, made popular in the 1930's by Tashko-Koço. With a restaged performance by a young performer connected to the LGBT/human rights organization Aleanca LGBT in the run down mausoleum Piramida – the connotations and meaning of the song are investigated. It raises questions on how existing narratives are being used, how these can be interpreted, and how one create identification and make them one's own, when nothing else is there. *Koncert në Vitin 2014* was made possible through a close collaboration with the Albanian organization Aleanca LGBT and the Swedish Unstraight Museum.

OPA

OPA (Obsessive Possessive Aggression) është themeluar në vitin 2001 nga artistët vizual Slobodanka Stevceska (lindur më 1971, Shkup, Maqedoni) dhe Denis Saraginovski (lindur më 1971, Shkup, Maqedoni.) Të dy kanë studiuar në Fakultetin e Arteve të Bukura

në Shkup dhe janë duke punuar në fushën e artit, medias dhe performancës. OPA ka pasur ekspozita individuale në Maqedoni, Estoni, Slloveni, Kroaci, Francë, Gjermani, SHBA dhe Holandë, dhe gjithashtu kanë ekspozuar në shumë ekspozita grupore si: Transmediale, Berlin; Transeuropa - European Theatre- and Performance Festival, Hildesheim; Freewaves' Biennial of New Media Arts, Los Angeles; Biennale of Contemporary Art, Moscow; Victory Obsessed, Poznan, etc. OPA ka fituar bursa për rezidencë në Estoni, Francë, Gjermani, Zvicër dhe Holandë; Gjithashtu ka fituar cmimin "Dragisa Nanevski" në "AKTO Festival of Contemporary Arts", Bitola (2010) dhe "Young Visual Artists Annual Award DENES" (2004).

"PROJECT WHICH IS NOT A PROJECT" video, 42 minuta, 2006

Projekti ishte një udhëtim. Gjatë viteve 2003 - 2004 OPA (Obsessive Possessive Aggression) udhëtuan nëpër Evropë me një makinë 40 vjet të vjetër. Udhëtimi është bërë me mjete modeste dhe kështu përgjatë tij kanë ndodhur aventura dhe vështirësi të ndryshme. Aplikimet për viza, përballja me rregullat e administratës së ambasadave, prishja e makinës gjatë motit të keq, mungesa e parave kur duheshin për pjesë këmbimi për makinën ishin pengesa që përsëriteshin. Dokumentimi i udhëtimit është një kritikë për murin Schengen dhe tregon se çfarë do të thotë ai për artistët nga Ballkani. Makina bëhet shumë më shumë se sa një mjet transporti, ajo kthehet në një mjet komunikimi mes njerëzve. Në vitin 2006 OPA bën përsëri një udhëtim nga Maqedonia në Gjermani. Me nisjen nga Maqedonia, udhëtimi adreson zhvillimet e fundit politike në Maqedoni. Në këtë kuptim makina është rregulluar për të hyrë në BE. Videoja 42 minutëshe është zhvilluar nga këto materiale si dhe materialet e mbledhura nga udhëtimet e kaluara.



"PROJECT WHICH IS NOT A PROJECT" publikimi, 2012

Publikimi përfshinë shkrimet dhe fotomaterialet e mbledhura, duke u fokusuar në pamjen, pritjet dhe reflektimin ndaj skenës së artit europian.



OPA (Obsessive Possessive Aggression) was founded in 2001 by the visual artists Slobodanka Stevceska (*1971, Skopje, Macedonia) and Denis Saraginovski (*1971, Skopje, Macedonia). Both of them studied at the Faculty of

OPA

Fine Arts in Skopje and are working on the borderline of art, media and performance. OPA has had solo exhibitions in Macedonia, Estonia, Slovenia, Croatia, France, Germany, USA and the Netherlands and has exhibited widely in group exhibitions and festivals such as Transmediale, Berlin; Transeuropa - European Theatre- and Performance Festival, Hildesheim; Freewaves' Biennial of New Media Arts, Los Angeles; Biennale of Contemporary Art, Moscow; Victory Obsessed, Poznan, etc. OPA was granted residency fellowships in Estonia, France, Germany, Switzerland and the Netherlands; and received Dragisa Nanevski Award at AKTO Festival of Contemporary Arts, Bitola (2010) and Young Visual Artists Annual Award DENES (2004).


“PROJECT WHICH IS NOT A PROJECT” video, 42 minutes, 2006

